



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

KONKURS PUBLIK PËR DIZAJNIMIN E LOGOS së ZKA-së

Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës, shpall konkurs dhe u bën thirrje të gjithë të interesuarve pa dallim moshe, që të bëhen pjesë e garës për dizajnimin e Logos, së ZKA-së.

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga një komision profesional i themeluar nga Auditori i Përgjithshëm i ZKA-së :

- Të jetë kuptimplotë dhe të shprehë funksionin, mandatin dhe detyrat e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)
- Logoja duhet të ketë një pasqyrim artistik të veprimtarisë së ZKA-së
- Të jetë unike, të reflektojë vizionin, misionin dhe vlerat e ZKA-së
- Duhet të kuptohet lehtësisht
- Duhet të përçojë mesazh të qartë
- Të jetë e dallueshme, që i reziston kohës dhe e lehtë për tu mbajtur në mend
- Duhet të jetë lehtë e përshtatshme në dokumente fizike dhe në paraqitje elektronike, në internet dhe në shtyp, në sfonde të bardha dhe të errëta
- E qartë edhe në madhësi të ndryshme, p.sh. shumë të vogël (vizitkarta) ose madhësi shumë të mëdha (billboard)
- Logo e ZKA-së duhet të jetë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- Logoja duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur me shifër dhe pa emër të autorit në CD, bashkë me një version vektor të logos dhe po ashtu e shtypur në kopje fizike, krahas duhet bashkangjitur edhe një manual të shpjegimeve të përmbajtjes dhe përdorimit.
- Të drejtë konkurimi kanë të gjithë artistët nga Kosova, rajoni dhe bota.

Konkursi është i natyrës garuese dhe ideja më e mirë e përzgjedhur do të shpërblehet me 950€.

Të drejtat e autorit, për propozimet e përzgjedhura, barten nga propozuesi tek Zyra Kombëtare e Auditimit

Informata shtesë lidhur me mandatin, funksionin dhe detyrat e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ligjit 05/L-055, Auditori i Përgjithshëm është i pavarur nga ana funksionale, financiare dhe operative dhe nuk i nënshtrohet urdhrit ose ndikimit nga cilido person apo institucion tjetër. Auditori i Përgjithshëm si kreu i Zyrës Kombëtare të Auditimit, i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në ligj, aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit publik. Në përputhje me këtë, Auditori i Përgjithshëm ka liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave, në veçanti nuk i nënshtrohet kurrfarë urdhri për sa i përket auditimeve që duhet të kryhen, mënyrës si të bëhet një auditim dhe përparësisë që duhet dhënë një çështje të caktuar.

Zyra Kombëtare e Auditimit zbaton mandatin e saj në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, kryen auditime dhe ushtron funksionet e saj në mënyrë të pavarur nga çdo organ apo autoritet tjetër i Republikës së Kosovës; ka buxhetin e saj të cilin e administron në mënyrë të pavarur dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi; jep rekomandime dhe kontribuon në menaxhimin e e shëndoshë të buxhetit dhe fondeve tjera publike; promovon standardet e larta për transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin financiar dhe performancën e administratës publike; dorëzon raportet e auditimit tek Kuvendi dhe entitetet e audituara.

Vizioni i Zyrës Kombëtare të Auditimit: *“Institucion i besueshëm i auditimit që përmirëson qeverisjen në sektorin publik në interes të qytetarëve”*

Misioni: *“Përmes auditimeve cilësore fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare”.*

Vlerat e Zyrës Kombëtare të Auditimit: *Pavarësia, Profesionalizmi, Integriteti dhe Transparenca.*

Për më shumë ju lutem shihni [Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës 05/L-055](#) dhe vizitoni faqen tonë www.oag-rks.org

Kushtet për aplikim me propozime:

Të drejtë aplikimi me propozime për Logon:

1. kanë personat fizik dhe juridik.
2. propozimet duhet të dorëzohen në letër dhe në formë elektronike.

Ne rast te aplikimit si Operator Ekonomik/person juridik:

a.1) Në mënyrë që të dëshmohet se është i përshtatshëm, operatori ekonomik/personi juridik duhet t'i dorëzojë regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik;

Ne rast te aplikimit si person fizik:

a.2) Në mënyrë që të dëshmohet se është i përshtatshëm, personi fizik duhet te dorëzojë regjistrimin ne regjistrin civil dhe regjistrimin për numër fiskal prane ATK.

DËSHMITE E KËRKUAR DOKUMENTARE:

b.1) Kopja e certifikates se regjistrimit te biznesit te operatorit ekonomik ne regjistrat profesional, komercial dhe te korporatave ne vendin e tij te themelimit;

b.2) Kopja e njërit nga dokumentet personale te identifikimit, lëshuar nga zyra për regjistrim civil ne vendin e regjistrimit dhe kopja e numrit fiskal.

Dorëzimi

Punimet duhen të jenë në pliko të mbyllura dhe të kenë shifrën “ Për dizajnin ideor të logos”

Data e fundit për aplikim 09.03.2018

Për të aplikuar drejtohuni tek Zyra e Prokurimit të ZKA-së

Jehona Krasniqi, Udhëheqëse e Prokurimit

Zyra Kombëtare e Auditimit

Rr. Musine Kokollari 87

10000 Prishtina, Kosova

+ 381 (0)38 6060041014 (zyre)

+ 377 (0)45 110 109 (mobil)

<http://www.oag-rks.org>